1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

1. Uniformë pune për operatorët e centralit dhe të sallës operatorë.

Uniformë profesionale e përbërë nga bluzë dhe pantallona, e projektuar për përdorim në ambiente me kërkesa të larta higjieno-sanitare si centralet e sterilizimit. E prodhuar me material tekstil përzierje poliestër/pambuk (65% poliestër/35% pambuk ($\pm 3\%$)), me strukturë bikomponente, peshë 160–180 g/m².

Materiali është me aftësi të lartë transpirimi, që mundëson largimin e djersës nga brenda jashtë, duke e mbajtur trupin të thatë gjatë gjithë kohës. Falë strukturës bikomponente, uniforma ruan freskinë dhe nuk ngjitet në trup gjatë punës.

Të dhëna teknike të tekstilit të përdorur:

Përbërja (ISO 1833: 2019): 65% poliestër /35% pambuk ($\pm 3\%$);

Pesha (ISO 3801:1977) : 160–180 g/m²;

Rezistencë në tërheqje (ISO 13934-1:2013): Baza ≥ 1100 N Indi ≥ 500 N;
Rezistenca në grisje (ISO 13937-3:2000): Baza ≥ 20 N Indi ≥ 20 N;
Stabiliteti dimensional (ISO 6330:2000): Baza $\pm 3\%$ Indi $\pm 3\%$;
Rezistenca ndaj abrazionit (ISO 12947-2:2002): $> 15\,000$ cikle.

Bluza:

- Model ergonomik me mëngë të shkurtra.
- Jakë e formuar nga dy pjesë materiali që mbivendosen në pjesën e përparme, duke krijuar një efekt të butë “V” qepje e sheshtë për të shmangur iritimin e lëkurës.
- Tre xhepa funksionale (një në gjoks dhe dy në pjesën e poshtme).
- Material rezistente ndaj larjeve të shpeshta në temperatura të larta (deri në 60-90°C sipas standardeve të higjienës spitalore).
- Material rezistent ndaj kimikateve të lehta dezinfektuese.
- Në pjesën e gjoksit, në krahun e majtë ku ndodhet dhe xhepi, të vendoset logo e institucionit, e realizuar me: qëndisje.
- Dimensionet e logos: gjerësi 7–9 cm dhe lartësi 2.5–4 cm.
- Logo duhet të jetë më e vogël se gjerësia e xhepit. Të lihet 1–2 cm hapësirë nga buza e sipërme e xhepit
- Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme të uniformës dhe përmban: Emrin e furnizuesit; Masën; Përbërjen e materialit; Udhëzimet e larjes dhe mirëmbajtjes; Masa: Nga S deri XXL.

Pantallonat:

- Model i drejtë, komod për lëvizje të lirë gjatë punës.
- Bel elastik dhe me kordon rregullues.
- Dy xhepa anësorë funksionale.
- Qepje të përforcuara në zonat me konsum të lartë.
- Material i njëjtë me bluzën për uniformitet dhe rezistencë.
- Masa: Nga S deri XXL

Karakteristika shtesë të materialit:

- Antibakterial dhe kundër aromave.
- Rezistencë ndaj dezinfektuesve dhe detergjentëve profesionalë.
- Ngjyra të qëndrueshme ndaj larjes dhe përdorimit intensiv.
- Material jo toksik dhe hipoalergjik.

Qepja dhe përpunimi:

- Qepje industriale me rezistencë të lartë.
- Fije qepjeje në të njëjtën ngjyrë dhe cilësi si materiali bazë.
- Përfundime të pastra dhe rezistente ndaj konsumit.

Ngjyra: #000033 - Blu e errët.

2. Uniformë pune për përgjegjesat e centralit dhe të sallës operatore.

Uniformë profesionale e përbërë nga bluzë dhe pantallona, e projektuar për përdorim në ambiente me kërkesa të larta higjieno-sanitare si centralet e sterilizimit. E prodhuar me material tekstil përzierje poliestër/pambuk (65% poliestër/35% pambuk ($\pm 3\%$), me strukturë bikomponente, peshë 160–180 g/m².

Materiali është me aftësi të lartë transpirimi, që mundëson largimin e djersës nga brenda jashtë, duke e mbajtur trupin të thatë gjatë gjithë kohës. Falë strukturës bikomponente, uniforma ruan freskinë dhe nuk ngjitet në trup gjatë punës.

Të dhëna teknike të tekstit të përdorur:

Perberja (ISO 1833: 2019): 65% poliestër/35% pambuk ($\pm 3\%$);

Pesha (ISO 3801:1977) : 160–180 g/m²;

Rezistencë në tërheqje (ISO 13934-1:2013): Baza ≥ 1100 N Indi ≥ 500 N;

Rezistenca në grisje (ISO 13937-3:2000): Baza ≥ 20 N Indi ≥ 20 N;

Stabiliteti dimensional (ISO 6330:2000): Baza $\pm 3\%$ Indi $\pm 3\%$;

Rezistenca ndaj abrazionit (ISO 12947-2:2002): $> 15\,000$ cikle.

Bluza:

- Model ergonomik me mëngë të shkurtra.
- Jakë e formuar nga dy pjesë materiali që mbivendosen në pjesën e përparme, duke krijuar një efekt të butë “V” qepje e sheshtë për të shmangur irritimin e lëkurës.
- Tre xhepa funksionale (një në gjoks dhe dy në pjesën e poshtme).
- Material rezistente ndaj larjeve të shpeshta në temperatura të larta (deri në 60-90°C).
- Material rezistent ndaj kimikateve të lehta dezinfektuese.
- Në pjesën e gjoksit, në krahun e majtë ku ndodhet dhe xhepi, të vendoset logo e institucionit, e realizuar me: qëndisje.
- Dimensionet e logos: gjerësi 7–9 cm dhe lartësi 2.5–4 cm.
- Logo duhet të jetë më e vogël se gjerësia e xhepit. Të lihet 1–2 cm hapësirë nga buza e sipërme e xhepit
- Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme të uniformës dhe përmban: Emrin e furnizuesit; Masën; Përbërjen e materialit; Udhëzimet e larjes dhe mirëmbajtjes; Masa: Nga S deri XXXL.

Pantallonat:

- Model i drejtë, komod për lëvizje të lirë gjatë punës.
- Bel elastik dhe me kordon rregullues.
- Dy xhepa anësorë funksionale.
- Qepje të përforcuara në zonat me konsum të lartë.
- Material i njëjtë me bluzën për uniformitet dhe rezistencë.
- Masa: Nga S deri XXXL.

Karakteristika shtesë të materialit:

- Antibakterial dhe kundër aromave.
- Rezistencë ndaj dezinfektuesve dhe detergjentëve profesionalë.
- Ngjyra të qëndrueshme ndaj larjes dhe përdorimit intensiv.
- Material jo toksik dhe hipoalergjik.

Qepja dhe përpunimi:

- Qepje industriale me rezistencë të lartë.
- Fije qepjeje në të njëjtën ngjyrë dhe cilësi si materiali bazë.
- Përfundime të pastra dhe rezistente ndaj konsumit.

Ngjyra: #004B49 – Petrolio e errët

3. Uniformat për sanitarët nëpër centralet e sterilizimit.

Uniformë profesionale e përbërë nga bluzë dhe pantallona, e projektuar për përdorim në ambiente me kërkesa të larta higjieno-sanitare si centralet e sterilizimit. E prodhuar me material tekstil përzierje poliestër/pambuk (65% poliestër /35% pambuk ($\pm 3\%$)), me strukturë bikomponente, peshë 160–180 g/m².

Materiali është me aftësi të lartë transpirimi, që mundëson largimin e djersës nga brenda jashtë, duke e mbajtur trupin të thatë gjatë gjithë kohës. Falë strukturës bikomponente, uniforma ruan freskinë dhe nuk ngjitet në trup gjatë punës.

Të dhëna teknike të tekstilit të përdorur:

Përbërja (ISO 1833: 2019): 65% poliestër / 35% pambuk ($\pm 3\%$);

Pesha (ISO 3801:1977) : 160–180 g/m²;

Rezistencë në tërheqje (ISO 13934-1:2013): Baza ≥ 1100 N Indi ≥ 500 N;

Rezistenca në grisje (ISO 13937-3:2000: Baza ≥ 20 N Indi ≥ 20 N;

Stabiliteti dimensional (ISO 6330:2000): Baza $\pm 3\%$ Indi $\pm 3\%$;

Rezistenca ndaj abrazionit (ISO 12947-2:2002): $> 15\,000$ cikle.

Bluza:

- Model ergonomik me mëngë të shkurtra.
- Jakë “V” qepje e sheshtë për të shmangur irritimin e lëkurës.
- Tre xhepa funksionale (një në gjoks dhe dy në pjesën e poshtme).
- Material rezistente ndaj larjeve të shpeshta në temperatura të larta (deri në 60–90°C sipas standardeve të higjienës spitalore).
- Material rezistentë ndaj kimikateve të lehta dezinfektuese.
- Në pjesën e gjoksit, në krahun e majtë ku ndodhet dhe xhepi , të vendoset logo e institucionit, e realizuar me: qëndisje.
- Dimensionet e logos: gjerësi 7–9 cm dhe lartësi 2.5–4 cm.
- Logo duhet të jetë më e vogël se gjerësia e xhepit. Të lihet 1–2 cm hapësirë nga buza e sipërme e xhepit
- Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme të uniformës dhe përmban: Emrin e furnizuesit; Masën; Përbërjen e materialit; Udhëzimet e larjes dhe mirëmbajtjes; Masa: Nga S deri XXL.

Pantallonat:

- Model i drejtë, komod për lëvizje të lirë gjatë punës.
- Bel elastik dhe me kordon rregullues.
- Dy xhepa anësorë funksionale.
- Qepje të përforcuara në zonat me konsum të lartë.
- Material i njëjtë me bluzën për uniformitet dhe rezistencë.
- Masa: Nga S deri XXL.

Karakteristika shtesë të materialit:

- Antibakterial dhe kundër aromave.
- Rezistencë ndaj dezinfektuesve dhe detergjentëve profesionalë.
- Ngjyra të qëndrueshme ndaj larjes dhe përdorimit intensiv.
- Material jo toksik dhe hipoalergjik.

Qepja dhe përpunimi:

- Qepje industriale me rezistencë të lartë.
- Fije qepjeje në të njëjtën ngjyrë dhe cilësi si materiali bazë.

- Përfundime të pastra dhe rezistente ndaj konsumit.

Ngjyra: #5A2A5A - Vjollcë e erret

4. Uniformat për puntorët e magazines

Pantallona: pune profesionale tip kargo, të përshtatshme për aktivitete logjistike dhe magazinimi.

- Përbërja: 65% poliestër ($\pm 3\%$) / 33% pambuk ($\pm 3\%$) / 2% spandex (ose ekuivalente);
- Gramatura: 240–280 g/m²;
- Rezistencë ndaj grisjes dhe konsumit;
- Ngjyrë: e zezë;
- Bel me sythe për rrip (min. 5) dhe llastik në pjesën e pasme;
- Mbyllje me zinxhir dhe kopsë të përforcuar;
- Prerje ergonomike (regular fit);
- 2 xhepa anësorë përpara;
- 2 xhepa kargo në kofshë me kapak;
- 2 xhepa të pasëm me kapak;
- Qepje të dyfishta/trefishe;
- Përforcime në zona kritike;
- Masa: Nga 40 deri 56.

Bluzë: pune me mëngë të shkurtra për përdorim të përditshëm.

- 100% pambuk;
- Gramatura: 150–180 g/m²;
- Material i ajroshëm dhe absorbues;
- Ngjyrë: e zezë;
- Jakë e rrumbullakët (crew neck);
- Mëngë të shkurtra;
- Jakë me shirit përforcues;
- Qepje cilësore rezistente ndaj larjeve;
- Logo: Në lartësinë e gjoksit në krahun e djathtë të ketë me qëndisje logon e OSHIS, me gjerësi 7-9 cm dhe lartësi 2.5-3 cm në skajet më të larta;
- Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masën dhe referencën për matjet anatomike; Masa: Nga S deri XXL.

Kërkesa të përgjithshme

- Rezistente ndaj larjeve të shpeshta (40°C).
- Të disponueshme në madhësi S–XXL.
- Të përshtatshme për përdorim të përditshëm në ambiente pune.

Këpucë sigurie (antinfornio) për punëtorë magazine: të projektuara për mbrojtje dhe rehati gjatë përdorimit të zgjatur në ambiente logjistike dhe industriale të lehta. Produkti duhet të përmbushë standardin **EN ISO 20345:2011** me kategori S3 (SRC) dhe të jetë i pajisur me shenjë CE. Këpucët duhet të kenë mbrojtje të gishtave me kapak celiku rezistent ndaj goditjeve deri në 200 J, shollë e mesme celiku kundër shpimit për mbrojtje nga objekte të mprehta, si dhe shollë antirrëshqitëse (SRC) për përdorim në sipërfaqe të thata dhe të lagështa. Duhet të jenë antistatike dhe të kenë sistem absorbimi të energjisë në pjesën e thembrës për reduktimin e lodhjes gjatë punës.

Pjesa e sipërme rekomandohet të jetë prej lëkure, ndërsa pjesa e brendshme duhet të jetë e ajroshme dhe antibakteriale për komoditet maksimal. Sholla e jashtme duhet të jetë prej

materialesh rezistente si PU/PU ose PU/TPU, me qëndrueshmëri ndaj konsumit, vajrave dhe hidrokarbureve. Dizajni duhet të jetë ergonomik, me formë të përshtatshme për këmbën, model i ulët ose i mesëm, në ngjyrë të zezë ose të errët, me sistem mbylljeje me lidhëse ose alternativë të përshtatshme. Këpucët duhet të kenë shtrojë të brendshme anatomike dhe të zëvendësueshme, të ofrojnë ajrosje të mirë dhe peshë të reduktuar për përdorim të përditshëm.

Produkti duhet të jetë rezistent ndaj konsumit dhe i përshtatshëm për përdorim intensiv në magazina, transport dhe ambiente logjistike, duke garantuar siguri, qëndrueshmëri dhe rehati për përdoruesin. Disponueshmëria duhet të jetë në një gamë të plotë madhësish, zakonisht nga 36 deri në 46.

5 . Uniforma për operatorët e mbetjeve të rrezikshme.

Pulovër dimërore. Pulovra me material poliestër, me zinxhir për hapje në pjesën e përparme, me mëngë të gjata, është e realizuar me material të butë, 100 % poliestër, pesha 240 g/m² ±5 %, kundra pushavitjes, i lëmuar nga të dyja anët. Peri që do të prodhohen mostrat do të jetë sipas fijes së vetë uniformës. Me jakë të lartë me lartësi 5-7 cm me ngjyrë të kuqe. Me mbyllje qëndrore me zinxhir. Një xhep vertikal në pjesën e djathtë të gjoksit, me mbyllje me zinxhir, me gjatësi 14-16 cm. Vizë evidentuese me ngjyrë të kuqe, në krah të djathtë të zinxhirit. Në pjesën e sipërme të krahut të majtë të gjoksit, paralel me xhepin e krahut të djathtë të ketë një kuadrat (me përmasa lartësi 7-9 cm dhe gjërësi 2.5-3 cm) me qëndisje të logos. Dy xhepa të pjerrët në pjesën e përparme të poshtme dhe të mbyllur me zinxhir me gjatësi 16-18 cm. Vizë evidentuese me ngjyrë të kuqe të kapakët e xhepave të pjerrët. Pjesa e kyçeve, fundi i bluzës dhe pjesa anësore të jenë elastike për një përshtatje më të mirë. Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masën dhe referencën për matjet anatomike, udhëzimet e larjes, përbërjen e copës, vitin e prodhimit.

Prerjet: Nga XS në 4XL.

Ngjyra: Të zezë.

Pajtuueshmëria me Kërkesat e Përgjithshme: EN ISO 13688:2013.

Pantallona

Pantallonat verore të jenë të prodhuara me material bielasik, rip-stop (me kuadrate të vogla), që nuk lejon hyrjen e gjakut, lëndëve biologjike etj, me 5 xhepa. Zmbraps ujin, lejon ajrosjen, kundra erës. Përbërja fibroze (AATCC 2013 + Reg. 1007/2011): ≥ 90% poliestër, ≤10 % elastan. Masa 205 g/m² ± 5% sipas normës SSH EN 12127:1999 dhe rezistenca ndaj avujve të jetë ≤ 3 m² Pa/W, sipas normës EN 11092. Material antibakterial. Peri që do të prodhohen mostrat do të jetë sipas fijes së vetë uniformës. Pjesa e gjunjëve të jetë e mbrojtur me material përforcues rezistente ndaj gërryerjes, kundër rrëshqitjes, që nuk lejon hyrjen e gjakut, lëndëve biologjike etj. Masa 270 g/m² ± 5% sipas normës SSH EN 12127:1999. Resistenca ndaj abrazionit sipas normës SSH EN ISO 12947-1 ≥ 250.000 cikle. Mbyllje me zinxhir dhe me kapak me percina në pjesën e përparme. Dy xhepat anësorë përpara të prerë në forme të pjerrët, të mbyllur me zinxhir dhe të mbuluar me kapak, me gjatësi 17-19 cm (në madhësinë L). Dy xhepa të mëdhenj, me hapje fizarmonike, të mbyllur me zinxhir përpara, në pjesën e kofshëve, me zinxhir me gjatësi 16-18 cm. Një xhep i pestë në pjesën e mbrapme të djathtë horizontal, i mbyllur nga një fileto me zinxhir me gjatësi 14-16 cm. Mbyllje qëndrore me gjysëm zinxhiri me gjatësi 14-16 cm dhe me percina, 5 ylyqe në bel (lartësi prej 5 cm dhe një gjerësi 2 cm), prej të cilavë 2 në zonën e përparme dhe 3 në pjesën e pasme. Të gjithë zinxhirët janë të pajisur me tërheqës me gjatësi 5-7 cm. Fundi i këmbëve të pantallonave me bordurë të thjeshtë, me lak të brendshëm, të rregullueshëm.

Dy shirita horizontal reflektiv të segmentuar (të ndërprerë) me teknologji mikro-sferike, të pozicionuar paralel në këmbë, në pjesën e kërcirit, një poshtë gjurit dhe një sipër kaviljes, me lartësi 7-9 cm.

Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masën dhe referencën për matjet anatomike, normat e certifikimit për Pajisjet për Mbrojtjen Personale, udhëzimet e larjes, përbërjen e copës, vitin e prodhimit.
-Masat nga XS deri në 4XL.
Ngjyrë HV me kod #FE0100. Standardi EN 20471.

Artikulli të prodhohet me materiale në përputhje me sistemin e kontrollit OEKO-TEX (Standardi 100 Klasa e Prodhuesit 2).
Certifikuar sipas normativave SSH EN ISO 13688:2013, SSH EN ISO 20471:2017 Klasa 2.

Bluza

Bluze polo me mëngë të shkurtra, e prodhuar me material bikomponentësh 63% poliamid /37% polipropilen ($\pm 3\%$), thurja piqué, pesha 160 g/m² ($\pm 5\%$) sipas normes SSH EN 12127:1999, hidrofobik për nxjerrjen e djersës dhe lejimin e transpirimit të trupit nga brenda jashtë. Jake polo me lartësi 6-8 cm e hapur, që mbyllet me 3 kopsa. Me perforime mikro-ventilimi në zonën e sqetullave për lejimin e transpirimit të trupit nga brenda jashtë. Peri që do të prodhohen mostrat do të jetë sipas fijes së vetë uniformës. Në lartësinë e gjoksit në krahun e djathtë të ketë me qëndisje logon e OSHIS, me gjerësi 7-9 cm dhe lartësi 2.5-3 cm në skajet më të larta. Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masën dhe referencën për matjet anatomike, udhëzimet e larjes, përbërjen e copës, vitin e prodhimit.

Masat: nga XS në 4XL
Ngjyra: E bardhë

Artikulli të prodhohet me materiale në përputhje me sistemin e kontrollit OEKO-TEX (Standardi 100 Klasa e Prodhuesit 2).
Pajtueshmëria me Kërkesat e Përgjithshme: EN ISO 13688:2013

Këpucë sigurie (antinfortunio) për punëtorë magazine: të projektuara për mbrojtje dhe rehati gjatë përdorimit të zgjatur në ambiente logjistike dhe industriale të lehta. Produkti duhet të përmbushë standardin **EN ISO 20345:2011** me kategori S3 (SRC) dhe të jetë i pajisur me shenjë CE. Këpucët duhet të kenë mbrojtje të gishtave me kapak celiku rezistent ndaj goditjeve deri në 200 J, shollë e mesme celiku kundër shpimit për mbrojtje nga objekte të mprehta, si dhe shollë antirrëshqitëse (SRC) për përdorim në sipërfaqe të thata dhe të lagështa. Duhet të jenë antistatike dhe të kenë sistem absorbimi të energjisë në pjesën e thembrës për reduktimin e lodhjes gjatë punës.

Pjesa e sipërme rekomandohet të jetë prej lëkure, ndërsa pjesa e brendshme duhet të jetë e ajroshme dhe antibakteriale për komoditet maksimal. Sholla e jashtme duhet të jetë prej materialesh rezistente si PU/PU ose PU/TPU, me qëndrueshmëri ndaj konsumit, vajrave dhe hidrokarbureve. Dizajni duhet të jetë ergonomik, me formë të përshtatshme për këmbën, model i ulët ose i mesëm, në ngjyrë të zezë ose të errët, me sistem mbylljeje me lidhëse ose alternativë të përshtatshme. Këpucët duhet të kenë shtrojë të brendshme anatomike dhe të zëvendësueshme, të ofrojnë ajrosje të mirë dhe peshë të reduktuar për përdorim të përditshëm.

Produkti duhet të jetë rezistent ndaj konsumit dhe i përshtatshëm për përdorim intensiv në magazina, transport dhe ambiente logjistike, duke garantuar siguri, qëndrueshmëri dhe rehati për përdoruesin. Disponueshmëria duhet të jetë në një gamë të plotë madhësish, zakonisht nga 36 deri në 46.

5. Uniforma për punonjësit e logjistikës.

Pantallona: pune profesionale tip kargo, të përshtatshme për aktivitete logjistike dhe magazinimi.

- Përbërja: 65% poliestër ($\pm 3\%$) / 33% pambuk ($\pm 3\%$) / 2% spandex (ose ekuivalente);
- Gramatura: 240–280 g/m²;
- Rezistencë ndaj grisjes dhe konsumit;
- Ngjyrë: e zezë;
- Bel me sythe për rrip (min. 5) dhe llastik në pjesën e pasme;
- Mbyllje me zinxhir dhe kopsë të përforcuar;
- Prerje ergonomike (regular fit);
- 2 xhepa anësorë përpara;
- 2 xhepa kargo në kofshë me kapak;
- 2 xhepa të pasëm me kapak;
- Qepje të dyfishta/trefishe;
- Përforcime në zona kritike;
- Masa: Nga 40 deri 56.

Bluzë : pune me mëngë të shkurtra polo për përdorim të përditshëm.

- 100% pambuk;
- Gramatura: 150–180 g/m²;
- Material i ajrosshëm dhe absorbues;
- Ngjyrë: e zezë;
- Mëngë të shkurtra.
- **Jakë polo** – Jakë e stilit klasik me formë të ulët si jakë këmishe, e shoqëruar me një **hapje të shkurtër përpara** që zakonisht mbyllet me **2–3 kopsa**. Ky tip jake kombinon pamje **formale dhe sportive**, duke ofruar rehati dhe ajrosje në zonën e qafës.
- Qepje cilësore rezistente ndaj larjeve Në lartësinë e gjoksit në krahun e djathtë të ketë me qëndisje logon e OSHIS, me gjerësi 7-9 cm dhe lartësi 2.5-3 cm në skajet më të larta.

-Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masën dhe referencën për matjet anatomike, normat e certifikimit për Pajisjet për Mbrojtjen Personale, udhëzimet e larjes, përbërjen e copës.

Kërkesa të përgjithshme

- Rezistente ndaj larjeve të shpeshta (40°C);
- Të disponueshme në madhësi S–XXL;
- Të përshtatshme për përdorim të përditshëm në ambiente pune.

Këpucë sigurie (antinfortunio) për punëtorë magazine: të projektuara për mbrojtje dhe rehati gjatë përdorimit të zgjatur në ambiente logjistike dhe industriale të lehta. Produkti duhet të përmbushë standardin **EN ISO 20345:2011** me kategori S3 (SRC) dhe të jetë i pajisur me shenjë CE. Këpucët duhet të kenë mbrojtje të gishtave me kapak celiku rezistent ndaj goditjeve deri në 200 J, shollë e mesme celiku kundër shpimit për mbrojtje nga objekte të mprehta, si dhe shollë antirrëshqitëse (SRC) për përdorim në sipërfaqe të thata dhe të lagështa. Duhet të jenë antistatike dhe të kenë sistem absorbimi të energjisë në pjesën e thembrës për reduktimin e lodhjes gjatë punës.

Pjesa e sipërme rekomandohet të jetë prej lekure, ndërsa pjesa e brendshme duhet të jetë e ajrosshme dhe antibakteriale për komoditet maksimal. Sholla e jashtme duhet të jetë prej materialesh rezistente si PU/PU ose PU/TPU, me qëndrueshmëri ndaj konsumit, vajrave dhe hidrokarbureve. Dizajni duhet të jetë ergonomik, me formë të përshtatshme për këmbën, model i ulët ose i mesëm, në ngjyrë të zezë ose të errët, me sistem mbylljeje me lidhëse ose alternativë të

përshtatshme. Këpucët duhet të kenë shtrojë të brendshme anatomike dhe të zëvendësueshme, të ofrojnë ajrosje të mirë dhe peshë të reduktuar për përdorim të përditshëm.

Produkti duhet të jetë rezistent ndaj konsumit dhe i përshtatshëm për përdorim intensiv në magazina, transport dhe ambiente logjistike, duke garantuar siguri, qëndrueshmëri dhe rehati për përdoruesin. Disponueshmëria duhet të jetë në një gamë të plotë madhësish, zakonisht nga 36 deri në 46.

6. Bluza dimërore me zinxhirë për personelin e centralit të sterilizimit, sallë operatore, magazinë, logjistikë.

Bluzë me zinxhir material stof i butë termik me zinxhir për personelin e sallës operatore dhe centralit të sterilizimit, e projektuar për përdorim si shtresë shtesë për mbrojtje termike dhe rehati në ambiente me temperatura të kontrolluara. Produkti duhet të jetë në përputhje me EN ISO 13688:2013 dhe EN 14058 Klasi 1, si dhe i realizuar nga material pelush sintetik termik (100% poliestër) me gramaturë të rekomanduar 260–320 g/m², i butë, i ajrosshëm dhe me tharje të shpejtë, duke garantuar komoditet gjatë përdorimit të zgjatur.

Bluza karakterizohet nga mbyllje përpara me zinxhir të plotë (full zip), jakë e lartë (stand/mandarin) për mbrojtje të qafës dhe mëngë të gjata me përfundim elastik, që sigurojnë izolim termik. Dizajni është ergonomik (reguluar fit) dhe i përshtatshëm për t'u veshur mbi uniformë sanitare, pa kufizuar lëvizjen. Mund të përfshijë 2 xhepa anësorë të integruar, ndërsa qepjet janë të qëndrueshme dhe të përforcuara për rezistencë ndaj përdorimit intensiv.

Materiali ofron izolim termik pa rënduar, ajrosshmëri dhe rezistencë ndaj larjeve të shpeshta (40°C), duke ruajtur formën dhe ngjyrën. Në lartësinë e gjoksit në krahun e djathtë të ketë me qëndisje logon e OSHIS, me gjerësi 7-9 cm dhe lartësi 2.5-3 cm në skajet më të larta. Etiketa: E vendosur në pjesën e brendshme dhe tregon emrin e furnizuesit dhe kodin e produktit, masën dhe referencën për matjet anatomike, normat e certifikimit për Pajisjet për Mbrojtjen Personale, udhëzimet e larjes, përbërjen e copës, vitin e prodhimit. Produkti është i disponueshëm në madhësi të ndryshme (**S–XXL**). I përshtatshëm për përdorim në ambiente spitalore jo sterile, korridore dhe zona të centralit të sterilizimit, ku kërkohet kombinim i rehatisë, funksionalitetit dhe mbrojtjes termike.

Ngjyra: #000033 Blu e errët

7. Shapka profesionale spitalore

Shapka profesionale monoblok të projektuara për qëndrueshmëri të gjatë dhe mirëmbajtje të lehtë. Realizuar me material EVA ultra të lehta, antibakteriale, antivirale, pa lateks, njëpjesëshe, anatomike dhe jo-rrëshqitëse, paraqet:

- Vrima anësore ventilimi;
- Thembrë e ngritur për një qëndrim korrekt trupor;
- Elemente masazhuese në shtrojën e brendshme për të favorizuar qarkullimin e gjakut;
- Rrip i pasëm i rregullueshëm, i aplikueshëm sipas kërkesës;
- Absorbim energjie në thembër;
- Përfshin një shtrojë të brendshme prej pëlhere me trajtim antibakterial;
- Peshë për një pale: 160-180 gram;
- Ngjyra: Portokalli dhe Blu;
- Larja: në lavatriçe në temperaturë 40°C;
- Tharja: me leckë të butë ose në temperaturë ambiente, larg burimeve direkte të nxehtësisë dhe dritës.

Certifikate CE.

Standard EN ISO 20347:2022, Antibakterial ISO 16187, Antiviral ISO 21702:2019, Livel i sigurisë OB+SR+E.

8. Pulovër

Cardigan profesional **unisex** me mëngë të gjata, i realizuar nga material 50% viskoze / 28% polyester / 22% poliamid ($\pm 3\%$). Model me hapje përpara me **kopsa**, jake “V”, dy xhepa pllake, dizajn ergonomik dhe prerje **unisex** që përshtatet për të dy gjinitë, duke ofruar rehati gjatë përdorimit të përditshëm në ambient pune.

Larje në temperaturë **30–40°C**, rezistent ndaj deformimit dhe ruan formën pas larjeve të shpeshta. I disponueshëm në masa të ndryshme, i përshtatshëm për personel administrativ ose përdorim të përgjithshëm.

Logo e qëndisur në anën e majtë, madhësi 6–8 cm, me rezistencë ndaj larjes dhe dezinfektimit. Etikete e vendosur në pjesën e brendshme të jakës ose në anën e brendshme të veshjes, i heqshëm nëse dëshirohet.

Duhet të përmbajë:

- Përbërjen e materialit;
- Masën (S–XXL);
- Udhëzimet e mirëmbajtjes (larje, tharje, hekurosje);
- Emrin ose markën e prodhuesit.

Ngjyra: #000033 Blu e errët

***Për të gjitha produktet e listuara, logoja do të realizohet në ngjyrat origjinale, në përputhje me logon dhe specifikimet grafike të vëna në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor.**

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Tabela përmbledhese me të gjitha zerat.

Llojet e uniformave	Njësi	Sasitë
Uniformë pune për operatorët e centralit të sterilizimit dhe sallat operatore (Bluzë+Pantallon)	Set	1300
Uniformë pune për përgjegjesat e centralit dhe të sallës operatore (Bluzë+Pantallon)	Set	170
Uniformat për sanitarët nëpër centralet e sterilizimit (Bluzë+Pantallon)	Set	80
Pantallona uniformë magazine dhe për uniformë për logjistikë	copë	185
Bluza uniformë magazine	copë	20
Bluza uniformë për mbetjet e rrezikshme	copë	25
Këpucë pune për magazinë dhe operator të mbetjeve të rrezikshme, vektorë dhe logjistikë	copë	32
Pantallona për operatorët e mbetjeve të rrezikshme	copë	25
Pulovër dimërore për operatorët e mbetjeve të rrezikshme	copë	6
Bluzë polo për logjistikë	copë	165
Bluza dimërore me zinxhirë për personelin e centralit të sterilizimit, sallë operatore, magazinë dhe logjistikë	copë	347
Shapka profesionale spitalore ngjyrë Portokalli	palë	310
Shapka profesionale spitalore Ngjyrë	palë	310

Blu		
Pulovër	copë	70

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një

nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikimin ISO 9001:2015, ose ekuivalente, për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë dhe ISO 14001:2015, ose ekuivalente, për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.3 Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikatë OEKO-TEX (Standardi 100, Klasa e Prodhuesit 2) ose ekuivalente, të vlefshme, të produktit ose të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve tekstilë objekt prokurimi, për të vërtetuar se lëndët e para të artikujve të ofruar nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të çertifikimit OEKO-TEX ose ekuivalente. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, çertifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për secilin nga prodhuesit. Për këtë OE pjesëmarrës duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi i produktit ose prodhuesi i lëndës së parë ku të bëhet lidhja midis prodhuesit dhe OE/distributorit të autorizuar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues, ose tregëtues i autorizuar nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për artikujt objekt prokurimi. Në rast se, ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre. Operatori ekonomik ofertues në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të ketë të përcaktuar të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, email, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogarinë të Autoritetit Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë prodhuesit e të gjitha mallrave objekt prokurimi me të dhënat e kontaktit.

2.3.5 Me qellim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë nga një mostër fizike për secilin nga artikujt (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike.

Mostrat e paraqitura duhet të kenë të trupëzuar një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, Objektin e Porcedurës për të cilin oferton, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmërinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do të shihet e arsyeshme.

Mungesa e mostrës është kusht s'kualifikues.

2.3.6 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (Raporte testi/analiza) të lendeve të para të produkteve, për artikujt “Uniformë pune për operatorët e centralit të sterilizimit dhe sallat operatore”, “Uniformë pune për përgjegjësat e centralit dhe të sallës operatore”, “Uniformat për sanitarët nëpër centralet e sterilizimit”, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara.

(Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndën e parë që shoqëron atë dhe ajo e fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike të prodhuesit për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajnë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

2.3.8 OE duhet të paraqesë certifikatë/deklaratë konformiteti CE për artikujt objekt prokurimi referuar specifikimeve teknike.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 10 punonjës për 3 muajt e fundit, nga data e hapjes së ofertave. Për plotësimin e kësaj kërkesë, operatori ekonomik duhet të dorëzojë një vërtetim për numrin e punonjësve të lëshuar nga Administrata Tatimore që vërteton se subjekti ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për 3 muajt e fundit, shoqëruar me listëpagesën e dorëzuar pranë organeve tatimore për 3 muajt e fundit.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).*

2.3.10 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në funksion të përmbushjes me sukses të kontrates duhet të vërtetojnë se disponojnë personel të kualifikuar, si më poshtë:

1. Të paktën një Inxhinier Tekstil.
2. Të paktën një Modelist.

Për sa më sipër operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

Për Inxhinierin Tekstil:

Kopje të diplomës;

Kontratën e punës (te vlefshme);

Kopje të librezës së punës;

Deklarimin e profilit të personelit të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit;

Listapagesat sipas formularit E-Sig 025/a për periudhën e kërkuar.

Për punonjës in Modelist:

Dokument që të vertetojnë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikate/diplome), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licensuara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.

Kontratën e punës (te vlefshme);

Kopje të librezës së punës;

Deklarimin e profilit të personelit të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit;

Listapagesat sipas formularit E-Sig 025/a për periudhën e kërkuar.

Personeli i kualifikuar duhet të jetë pjesë e përvojës së ofertuesit dhe për këtë OE duhet të dëshmojnë se kanë patur në listpagesat e shoqërisë për një periudhë jo më pak se tre muaj nga data e hapjes së ofertave, specialistët e sipërcituar.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).*

2.3.11 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht **10 makina qepese** në pronësi ose me kontratë qeraje/huapërdorje, për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin që provon pronësinë si kontratë shitblerje, dhurimi, fatura tatimore, deklarata zhdoganimi ose kontratë qeraje/huapërdorje.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).*

2.3.12 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht **1 makine transporti** në pronësi ose me kontratë qeraje/huapërdorje, për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

Mjeti i transportit duhet të jetë i pajisur me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, sigurancë mjeti (te vlefshme), certifikate e kontrollit teknik të mjetit (te vlefshme), taksat vjetore).

Ne rastin kur mjeti i transportit është me qera/huapërdorje duhet të paraqitet gjithashtu kontratë qeraje/huapërdorje notoriale për gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

